



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

# ANALIZË PUNE 2018



**PËRMBAJTJA**

<b>LISTA E SHKURTIMEVE</b> .....	- 2 -
Metodologjia për Përgatitjen e Raportit.....	- 3 -
Organizimi i Dokumentit.....	- 3 -
Funksionimi i ISHMT.....	- 3 -
<b>I. ARRITJET KRYESORE</b> .....	- 4 -
<b>II. RAPORTIMI I PUNËS PËR ÇDO DREJTORI</b> .....	- 8 -
<b>2.1 DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË PRODUKTEVE (DMP)</b> .....	- 8 -
<b>2.1.1. INSPEKTIVE TË KRYERA</b> .....	- 9 -
1. Inspektimi për sigurinë e lodrave.....	- 9 -
2. Inspektimi për sigurinë e detergjentëve.....	- 11 -
4. Inspektimet e përbërjes së fibrave të produkteve tekstile.....	- 13 -
5. Inspektive për parapaketim.....	- 14 -
6. Inspektive për instrumentat matës ligjërisht të kontrollueshme.....	- 15 -
7. Inspektive për produktet elektrike.....	- 16 -
<b>2.1.2 NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE TË DMP -SË</b> .....	- 17 -
<b>2.1.3 AKTIVITETE SENSIBILIZUESE</b> .....	- 18 -
<b>2.2. DREJTORIA E PRONËSISË INDUSTRIALE DHE INTELEKTUALE (DPII)</b> .....	- 19 -
<b>2.2.1. INSPEKTIVE TË KRYERA</b> .....	- 19 -
1. Inspektive për respektimin e të drejtave të autorit.....	- 20 -
2. Inspektive mbi pronësinë industriale.....	- 20 -
<b>2.2.2 NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE TË DPII</b> .....	- 21 -
<b>2.2.3. AKTIVITETE SENSIBILIZUESE</b> .....	- 22 -
<b>2.3 DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE NË TURIZËM (DMST)</b> .....	- 22 -
<b>2.3.1. INSPEKTIVE TË KRYERA</b> .....	- 23 -
1. Inspektimi i Agjencive të Udhëtimit & Operatorët Turistikë (AU & OT).....	- 23 -
<b>2.4 DREJTORIA TEKNIKE (DT)</b> .....	- 24 -
<b>2.5 SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b> .....	- 26 -
<b>III. ISHMT – SFIDA / KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b> .....	- 28 -
<b>3.1. Sfidat Gjatë Vitit 2018</b> .....	- 28 -

**LISTA E SHKURTIMEVE**

MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
ISHMT	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
IQ	Inspektorati Qendror
DAP	Drejtoria e Administratës Publike
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
DPM	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
DMP	Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve
DMST	Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve për Turizmin
DPII	Drejtoria e Pronësisë Industriale dhe Intelektuale
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
OJF	Organizata Jofitimprurëse
PKIE	Plani Kombëtar i Integritimit Evropian
RAPEX	Rapid Alert System for Non-Food Consumer Products
WIPO	World Intellectual Property Organization
NAWI	Non-automatic weighing instruments
MIDI	Measuring instruments

## Metodologjia për Përgatitjen e Raportit

Hartimi i këtij raporti bazohet në:

- ✓ Analizën e raporteve periodike të dorëzuar nga çdo sektor në lidhje me punën e kryer në terren (inspektime), problematikën e hasur dhe sugjerimet për përmirësimin në vazhdimësi;
- ✓ Përpunimin e statistikave të mbledhura mbi inspektimet e kryera gjatë kësaj periudhe kalendarike në raport me Indikatorët e Performancës;
- ✓ Rekomandimet nga aktorë të ndryshëm (publikë, privatë, ndërkombëtarë) me përvojë dhe eksperiencë në fushat që janë në fokusin e punës së ISHMT-së;
- ✓ Analizën e procedurave të inspektimeve, të performancës, proceseve gjyqësore, trajtimit të ankesave etj.
- ✓ Raportimet për Planin Kombëtar Për Integrimin Evropian (PKIE) 2017 – 2020 (kapitullin 1, kapitullin 7 dhe kapitulli 28 );
- ✓ Raportimet për Strategjinë Ndër-sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2020;
- ✓ Raportimet për Kontratën e Performancës me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë;
- ✓ Raportin për Inspektoratin Qendror (IQ) mbi inspektimet e realizuara në bazë të një liste indikatorësh të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm.

## Organizimi i Dokumentit

Pjesa e parë vë në pah arritjet kryesore të ISHMT-së për vitin 2018, në drejtim të përmbushjes së Objektivit Afatgjatë, Qëllimit dhe Rezultateve sipas Tabelës Logjike të funksionimit të Institucionit<sup>1</sup>. Në këtë pjesë përmbledhen sfidat e hasura gjatë vitit 2018 dhe mënyra se si janë adresuar ato për zgjidhje.

Pjesa e dytë e raportit paraqet punën e kryer gjatë 2018-ës për çdo drejtori sipas grup-produkteve e fushë-veprimtarisë së gjithsecilës.

Në pjesën e tretë të raportit, trajtohen konkluzionet, rekomandimet si dhe planifikimet për vitin e ardhshëm në lidhje me marrëdhëniet e bashkëpunimit ndër-institucional që do të ndikojnë në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së punës së këtij institucioni dhe të një mirë-koordinimi me institucionet e tjera publike, Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) dhe subjektet private.

## Funksionimi i ISHMT

ISHMT ka nisur funksionim e saj në janar 2017<sup>2</sup> e që në këtë kohë ka filluar gradualisht të operojë dhe të kryejë inspektime në treg sipas fushave të përgjegjësisë si më poshtë:

- a. mbrojtja e konsumatorëve, sipas përcaktimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- b. mbrojtja e pronësisë industriale, sipas përcaktimit të legjislacionit për pronësinë industriale;

<sup>1</sup> Tabela Logjike e Funksionimit të ISHMT-së është pjesë e Planit të Monitorimit dhe Vlerësimit, aprovuar nga Kryeinspektori i ISHMT-së në nëntor 2018.

<sup>2</sup> VKM Nr.36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”

- c. garantimi i mbrojtjes dhe i respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të legjislacionit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;
- d. Inspektimi metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë;
- e. Etiketimi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, sipas përcaktimit të legjislacionit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji;
- f. Kontrolli i detergjenteve të vendosura në treg sipas dispozitave të ligjit për detergjentet;
- g. Kontrolli i produkteve mekanike, ashensorë, pajisje të mbrojtjeve personale, etj..

## I. ARRITJET KRYESORE

### Grafiku Logjik i Funkcionimit të ISHMT-së

Puna e ISHMT-së organizohet sipas grafikut të mëposhtëm logjik (Fig.1), i cili është aprovuar në Planin e Monitorimit të institucionit në nëntor 2018, duke u bazuar në një sërë dokumentash, përfshirë këtu:

- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020
- Strategjia Ndër-sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut;
- Strategjia Ndër-sektoriale për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale 2020;
- Kontrata e Performancës së Kryeinspektorit të ISHMT-së me Ministrin e MFE-së;
- Inspektorati Qendror (IQ);
- Manuali Operacional për Mbikëqyrjen e Tregut të produkteve (jo ushqimore) në Shqipëri.

### Puna për arritjen e Objektivit Afatgjatë

**“Konsumatorë të fuqizuar, të sigurt dhe me besim në një treg të ndershëm, të sigurt dhe konkurrues, ku ata mund të marrin pjesë aktive duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mirë-informuar si dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale”**

ISHMT ka punuar së pari për t’u bërë evident në tregun e produkteve jo-ushqimore dhe në fushën e respektimit të pronësisë intelektuale si një institucion i sapokrijuar që ka në fokus kontrollin e respektimit të kriterëve ligjore sipas fushë veprimtarisë së tij. Kjo është arritur nëpërmjet informimit të operatorëve ekonomik, të bashkëpunimit me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe informimit të konsumatorit dhe operatorëve ekonomikë nëpërmjet hapjes dhe përditësimit të informacionit në adresën zyrtare [www.ishmt.gov.al](http://www.ishmt.gov.al).


Së dyti, nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018 të ndikojë në uljen e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore ku treguesi i uljes së mos-konformitetit për 2018 është **10.3 %**<sup>3</sup> si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Kjo arritje është për t’u nënvizuar për vetë faktin se ISHMT është një institucion relativisht i ri në tregun vendas ku

<sup>3</sup> Ky tregues mund të konsiderohet vetëm si një vlerë informuese dhe jo krahasuese sepse lidhet me disa faktorë që janë marrë në konsideratë gjatë inspektimeve të operatorëve ekonomikë si: Inspektimet për herë të parë të kryera nga ISHMT kanë pasur më shumë karakter informues dhe korigjues, shkalla e informimit të subjekteve në lidhje me kërkesat ligjore që duhet të respektojnë ishte shumë e ulët.

ka mbizotëruar kaosi i shkaktuar nga mungesa e kontrollit të deritanishëm. Inspektimet e vazhdueshme dhe të rregullta në treg, të shoqëruara nga fushata sensibilizuese kanë ndihmuar në përpjekjet institucionale për të arritur këtë Objektiv.

Së treti, për informimin e konsumatorit nga njëra anë mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe nga ana tjetër informimin e operatorëve ekonomikë për të respektuar kërkesat ligjore që janë të shprehura në legjislacionin aktual për të ofruar në treg produkte të sigurta. Kjo është arritur nëpërmjet aktiviteteve, trajnimeve të ndryshme të organizuar me pjesëmarrjen e grupeve të interesit, të fletëpalosjeve, botimeve informuese që jo vetëm janë shpërndarë tek konsumatori dhe operatorët ekonomik por edhe janë pasqyruar në website-n e ISHMT-së .

**Fig.1 : Grafiku logjik i funksionimit të ISHMT-së**



## Puna për arritjen e objektivit kryesor

### Objektivi kryesor

Përmirësim i sigurisë së produkteve për konsumatorët dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale”

**Rezultati 1:** Operatorët ekonomikë përmirësojnë praktikën dhe ofrojnë mallra në konformitet për konsumatorët dhe respektojnë të drejtat intelektuale dhe industriale.

**Rezultati 2:** Rritje e transparencës së tregut dhe praktikave tregtare për mbrojtjen e interesit ekonomik të konsumatorëve

Për të arritjen e rezultateve ISHMT ka punuar për përmbushjen e aktiviteteve të mëposhtme:

#### **Aktiviteti 1: Veprimtari mbikëqyrëse për respektimin e kriterëve ligjorë nga operatorët ekonomikë për produktet joushqimore dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale**

ISHMT ka kryer veprimtari mbikëqyrëse të shpeshta e të vazhdueshme të operatorëve ekonomikë për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Gjatë kësaj periudhe raportimi, ISHMT ka kryer **2014 inspektime në total** ku prioritet kanë qenë: inspektimi i lodrave, detergjenteve, instrumenteve matëse ligjorisht të kontrollueshme, para-paketimeve, produkteve elektrike, tekstileve, veshjeve të këpucëve, respektimi i të drejtave të autorit dhe respektimi i pronësisë industriale.

Inspektime të cilat kanë rezultuar me masa administrative zënë **15 %** kundrejt numrit total të inspektimeve. Megjithatë kjo shifër është e ulët, nuk është tregues real i tregut të sotëm shqiptar në lidhje me të qenit në konformitet. Duke marrë në konsideratë që: ISHMT është një institucion i ri i sapokrijuar dhe pjesa më e madhe e fushave që janë në fokusin e tij ishin të paezaurura më parë; ishin inspektimet e para që kryheshin ndaj operatorëve ekonomikë; shkallën shumë të ulët të njohurive të operatorëve ekonomikë në lidhje me kriteret ligjorë që duhet të respektojnë dhe zbatojnë; shkallën shumë të ulët të njohurive në lidhje me rregullat e reja teknike (transpozim i direktivave e BE-së në legjislacionin shqiptar), pjesa më e madhe e inspektimeve që janë kryer kanë pasur më shumë karakter informues ose janë shoqëruar me masa administrative paralajmërim si dhe masa korrigjuese.

Në lidhje me inspektimet mbi të drejtën e autorit që janë kryer gjatë kësaj periudhe janë lidhur nga operatorët ekonomikë **277 kontrata me SUADA-n** nga të cilat është përfituar një shumë **47,167,352 lekë**.

#### **Aktiviteti 2: Trajtim i Ankesave**

ISHMT ka trajtuar ankesat e konsumatorëve dhe/apo bizneseve mbi problematikat që dalin për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale. Inspektimet e ISHMT janë kryer me nismën e vetë institucionit, të planifikuara si dhe inspektime të kryera mbi bazë ankese të depozituara pranë ISHMT-së apo portalit të bashkëqeverisjes nga konsumatorët apo operatorët ekonomikë. Pjesa e inspektimeve të kryera mbi bazë ankese zënë **7.6 %** kundrejt numrit total të inspektimeve të kryera nga ISHMT. Kjo vlerë, edhe pse e vogël, tregon për një tendencë në rritje të ndërgjegjësimit të konsumatorit dhe operatorëve ekonomikë

për të adresuar shqetësimet e tyre në lidhje me sigurinë e produkteve dhe respektimit të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale në institucionin përgjegjës inspektues, ISHMT.

Në webin e ISHMT është krijuar një rubrikë e posaçme “ku çdo qytetar apo subjekt mund të plotësojë formularin e ankesës e cila më pas trajtohet nga strukturat përgjegjëse. Në programin e transparencës të pasqyruar në këtë ëeb është e afishuar lista e ankesave të ardhura dhe të trajtuara nga ana e ISHMT-së.

### Aktiviteti 3: Organizim i aktiviteteve sensibilizuese

Gjatë vitit 2018 janë organizuar **7(shtatë) aktivitete sensibilizuese** për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë. Në kryerjen e këtyre aktiviteteve ISHMT ka bashkëpunuar me GIZ por edhe me aktorë të tjerë si Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, Bashkia Tiranë, Shoqata e Konsumatorëve, ATA, etj.

Me mbështetjen e projektit të GIZ “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik e tregtar me Acquis-në e BE-së”, ISHMT ka realizuar një sërë aktiviteteve informuese për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë ku mund të përmendim: aktivitetin për sigurinë e lodrave me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve; për sigurinë e ashensorëve me administratorët e banesave të emëruar nga Bashkia Tiranë; me instaluesit dhe administratorët e spitaleve private, Qendrave Tregtare, hoteleve; për pronësinë industriale me operatorë ekonomikë, për të drejtat e autorit me dy kategori përdoruesish: programesh kompjuterike dhe përdorues të veprave letrare specifikisht fotokopje dhe shtypshkronja.

Në bashkëpunim me Unionin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, ISHMT ka organizuar dy takime me bizneset në qytetin e Elbasanit dhe Fierit. Gjatë aktiviteteve janë shpërndarë fletëpalosje informuese mbi: sigurinë e lodrave, sigurinë e detergjenteve, sigurinë e ashensorëve, përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve, sigurinë e pajisjeve elektrike të tensionit të ulët.



Janë botuar me mbështetjen e GIZ, **5 (pesë) fletëpalosje** për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë si dhe një Buletin Informues për operatorët ekonomikë mbi kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë për grup-produktet që janë në fokusin e punës së ISHMT-së. Në ëeb-site e ISHMT-së, krijimi i të cilit u mundësua përsëri nga GIZ janë pasqyruar të gjitha informacionet e nevojshme si për konsumatorët ashtu edhe për operatorët ekonomikë.

#### Informim i operatorëve ekonomikë

Pjesa më e madhe e inspektimeve të kryera nga ISHMT kanë qene edhe inspektime që kanë rezultuar me informim/këshillim të subjekteve. Inspektimet e rezultuara me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë zënë **53.1%** kundrejt numrit total të inspektimeve të kryera nga ISHMT. Gjithashtu për informimin e operatorëve ekonomikë janë përdorur edhe kanale të tjera informimi si shpërndarja e fletëpalosjeve me informacion të



nevojshëm mbi kriteret që duhet të respektojnë dhe zbatojnë operatorët ekonomikë, në përputhje me legjislacionin aktual dhe rregullat teknike të miratuara. Numri i operatorëve ekonomikë të informuar nëpërmjet inspektimeve dhe jashtë inspektimeve arrin në **2164** për vitin 2018.

#### **Aktiviteti 4 : Ngritja dhe forcimi i kapaciteteteve**

Ngritja dhe forcimi i kapaciteteteve të personelit për zbatimin me kompetencë të legjislacionin të harmonizuar mbi sigurinë e produkteve jo-ushqimore dhe të pronësisë intelektuale e industriale është trajtuar me prioritet të veçantë. Duke qenë një fushë-veprimtari e re inspektimi në tregun shqiptar, ISHMT ka identifikuar nevojat emergjente për trajnimin e stafit dhe ka arritur trajnimin 100% të stafit në lidhje mbi sigurinë e produkteve jo-ushqimore dhe mbi pronësinë intelektuale e industriale. Për vitin 2018 stafi i ISHMT-së ka marrë pjesë në **19 trajnime**.

Janë trajnuar **43 persona**, madje 50% e stafit është trajnuar më shumë se dy herë. Pjesa më e madhe e trajnimeve janë kryer në kuadrin e projektit GIZ “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik e tregtar me Acquis e BE-së” dhe Projektit “Quality Infrastructure in the Western Balkans” (Infrastruktura cilësore në Ballkanin Perëndimor).

#### **Aktiviteti 5 : Përmirësim i bazës ligjore**

ISHMT ka punuar në mënyrë të vazhdueshme për plotësimin dhe përmirësimin e legjislacionit sektorial të fushë-veprimtarisë së ISHMT-së.

Gjatë vitit 2018, ISHMT ka hartuar **dy rregullore**: Rregullore e Ankimeve Administrative dhe Rregullore e Trajtimit të Gjobave. Po ashtu, institucioni ka qenë pjesë e grupeve të punës për hartimin e draft Ligjit të ri për Metrologjinë në përputhje me direktivat e BE-së (iniciuar nga MFE) dhe draft Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre (iniciuar nga MIE).

## **II. RAPORTIMI I PUNËS PËR ÇDO DREJTORI**

### **2.1 DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË PRODUKTEVE (DMP)**

#### **Përshkrim i shkurtër**

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve përbëhet nga një staf prej 25 inspektorësh të ndarë në katër sektorë: Sektori i Produkteve Mekanike, Sektori i Produkteve Elektrike dhe Elektronike, Sektori i Inspektimit Metrologjik dhe Sektori Qelq/Këpucë/Detergjent/ Siguria e Produkteve.

Fusha e veprimtarisë së kësaj drejtorie është:

- ✓ Inspektimi i para-paketimeve;
- ✓ Inspektimi i instrumenteve matëse;
- ✓ Inspektimi për sigurinë e ashensorëve në përdorim;
- ✓ Inspektimi për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP);
- ✓ Inspektimi për pajisjet e gazit;

- ✓ Inspektimi për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosfera) potencialisht shpërthyes;
- ✓ Inspektimi për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit;
- ✓ Inspektimi për energjinë për kondicionerët e ajrit;
- ✓ Inspektimi për makinat larëse për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë;
- ✓ Inspektimi i tharëseve për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë;
- ✓ Inspektimi për sigurinë e lodrave;
- ✓ Inspektimi për detergjentët që bëhen të disponueshëm për konsumatorin;
- ✓ Inspektimi për materialet kryesore që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës;
- ✓ Inspektimi për produktet Qelq/Kristal;
- ✓ Inspektimi i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile.

### 2.1.1. INSPEKTIME TË KRYERA

Për vitin 2018 DMP ka pasur si prioritete:

- ✓ Inspektimet për parapaketim;
- ✓ Inspektimet e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrollueshme;
- ✓ Inspektimet për sigurinë e lodrave;
- ✓ Inspektimet për sigurinë e detergjenteve;
- ✓ Inspektimi për materialet kryesore që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës;
- ✓ Inspektimet e përbërjes së fibrave të produkteve tekstile;
- ✓ Inspektimet e produkteve elektrike.

Janë kryer gjithsej **1019 inspektime**, janë informuar rreth 355 subjekte dhe janë vendosur 141 masa administrative nga të cilat 52 gjoha , 63 paralamërimë dhe 26 masa urgjente me bllokim të mallit dhe shkatërrim të tij.

Numri inspektimeve mbi bazë ankese ka qenë 17. Janë kontrolluar **9128 produkte** nga të cilat **1183 kanë qenë jo në konformitet**.

## SEKTORI QELQ/KËPUCË/DETERGJENTË/SIGURIA E PRODUKTEVE

### 1. Inspektimi për sigurinë e lodrave

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 44 inspektime të operatorëve ekonomikë të kategorizuar si importues kryesorë të produkteve lodra<sup>4</sup>.

<sup>4</sup> Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011“Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore” dhe VKM Nr. 262/2013 për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”

Këto subjekte mbulojnë rreth 60 % të importeve në sasi (peshë dhe copë) në raport me totalin e Lodrave të importuara në një vit, referuar një baze të dhënash zyrtare përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Janë kontrolluar 378 produkte nga të cilat 106 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur 28 masa administrative nga të cilat vendosur 12 gjoha dhe 16 masa urgjente. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat e përmbledhura për këto lloj inspektimesh.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër	14	93
	Inspektime të kryera	numër	14	44
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër	0	0
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër	n/a	n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		25
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër	12	28
	<i>Gjoha</i>	numër	12	12
	<i>Paralajmërimi</i>	numër	0	0
	<i>Masa urgjente</i>	numër	4	16
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër	2	16
IND8	Ulja e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore në treg	%	8.3	28.1
	<i>Numër produktesh të kontrolluara</i>	numër	91	378
	<i>Numër produktesh jo në konformitet</i>	numër	76	106

## 2. Inspektimi për sigurinë e detergjentëve

ISHMT ka kryer 87 inspektime të operatorëve ekonomikë të kategorizuar importues/prodhues<sup>5</sup>. Janë kontrolluar 390 artikuj detergjentë nga të cilat 60 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur 18 masa administrative nga të cilat 17 gjoha dhe 1 masë urgjente. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat e përmbledhura për këto lloj inspektimesh.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		124
	Inspektime të kryera	numër		87
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		4
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		85
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me masë administrative	numër		18
	<i>Gjoha</i>	numër		17
	<i>Paralajmërimi</i>	numër		0
	<i>Masa urgjente</i>	numër		1
	<i>Masa korrigjuese</i>	numër		0
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		69
IND8	Ulja e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore në treg	%		15.4
	<i>Numër produktesh të kontrolluara</i>	numër		390
	<i>Numër produktesh jo në konformitet</i>	numër		60

<sup>5</sup> Në zbatim të Ligjit Nr. 10216, datë 21.1.2010 “Për Detergjentet” dhe VKM Nr. 669 datë 28.09.2011 “Për Etiketimin dhe të dhënat e përbërësve të detergjenteve”

### 3. Inspektimi për materialet kryesore që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës<sup>6</sup>

Janë kryer 37 inspektime ku janë kontrolluar 235 produkte nga të cilat 135 kanë qenë jo në konformitet dhe janë vendosur 16 masa administrative paralajmërim. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat e përmbledhura për këto lloj inspektimesh.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		41
	Inspektime te kryera	numër		37
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		6
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		32
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër		16
	<i>Gjoha</i>	<i>numër</i>		<i>0</i>
	<i>Paralajmërim</i>	<i>numër</i>		<i>16</i>
	<i>Masa urgjente</i>	<i>numër</i>		<i>0</i>
	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me korrigjime	numër		0
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		21
IND8	Ulja e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore në treg	%		57
	<i>Numër produktesh të kontrolluara</i>	<i>numër</i>		<i>235</i>
	<i>Numër produktesh jo në konformitet</i>	<i>numër</i>		<i>135</i>

<sup>6</sup> Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011“Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore” dhe VKM nr. 222, datë 28.03.2012 “Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”

#### 4. Inspektimet e përbërjes së fibrave të produkteve tekstile.

ISHMT ka kryer 65 inspektime, ku janë kontrolluar 448 produkte nga të cilat 169 kanë rezultuar jo në konformitet<sup>7</sup>. Janë vendosur 25 masa administrative paralajmërim. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat për këto lloj inspektimesh<sup>8</sup>.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		92
	Inspektime të kryera	numër		65
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		0
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		66
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër		25
	<i>Gjoba</i>	numër		0
	<i>Paralajmërim</i>	numër		25
	<i>Masa urgjente</i>	numër		0
	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me korrigjime	numër		0
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		40
IND8	Ulja e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore në treg	%		37.7
	<i>Numër produktesh të kontrolluara</i>	<i>numër</i>		448
	<i>Numër produktesh jo në konformitet</i>	<i>numër</i>		169

Në lidhje me inspektimin e tekstileve ISHMT ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Laboratorin e Akredituar të Universitetit Politeknik të Tiranës për kryerjen e disa llojeve analizash të produkteve tekstil./lëkurë.

<sup>7</sup> Në zbatim të Ligjit Nr. 10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore" dhe VKM nr. 1058, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile"

<sup>8</sup> Gjatë vitit 2017 nuk janë kryer inspektime në këtë fushë

## SEKTORI I METROLOGJISË

Sektori i inspektimit metrologjik me një numër total prej 10 inspektorësh i është bashkuar ISHMT-së gjatë vitit 2016 nga DPM ku kryente funksionet e inspektimit metrologjik, pas reformave të ndërmarra nga ana e qeverisë për përqendrimin e funksioneve të inspektimit në inspektorate.

### 5. Inspektime për parapaketim

Gjatë vitit 2018 sektori i Metrologjisë ka kryer 663 inspektime të subjekteve që tregtojnë me pakicë produkte të paketuara, të subjekteve prodhues dhe importues të parapaketimeve . Janë kontrolluar 2958 produkte nga të cilat kanë qenë jo në konformitet 395 produkte. Janë marrë në total 21 masa administrative nga të cilat 15 masa administrative me vendime gjobë dhe 5 masa administrative për ndalim të hedhjes në treg të produkteve, me qëllim korrigjimin e mospërputhjeve.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		825
	Inspektime te kryera	numër		663
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		1
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		663
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër		20
	<i>Gjoha</i>	<i>numër</i>		<i>15</i>
	<i>Paralajmërim</i>	<i>numër</i>		<i>1</i>
	<i>Masa urgjente</i>	<i>numër</i>		<i>4</i>
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		642
IND8	Ulja e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore në treg	%		12.5
	<i>Numër produktesh të kontrolluara</i>	<i>numër</i>		<i>2958</i>
	<i>Numër produktesh jo në konformitet</i>	<i>numër</i>		<i>372</i>

## 6. Inspektime për instrumentat matës ligjërisht të kontrollueshme

Gjatë vitit 2018 sektori i Metrologjisë ka kryer, krahas subjekteve që tregtojnë me pakicë produkte të paketuara, të subjekteve prodhues dhe importues të parapaketimeve, kontrolle të instrumenteve matës<sup>9</sup>. Janë kontrolluar 933 instrumente matës. Janë marrë në total 3 masa administrative nga të cilat 2 masa administrative me vendime gjobë dhe 1 masa administrative paralajmërim. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat e për këto lloj inspektimesh.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		825*
	Inspektime te kryera	numër		663*
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		9
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		663*
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër		3
	<i>Gjoha</i>	<i>numër</i>		2
	<i>Paralajmërim</i>	<i>numër</i>		1
	<i>Masa urgjente</i>	<i>numër</i>		0
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		660
IND8	Ulja e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore në treg	%		
	<i>Numër produktesh të kontrolluara</i>	<i>numër</i>		933
	<i>Numër produktesh jo në konformitet</i>	<i>numër</i>		

<sup>9</sup> Në zbatim të ligjit Nr.9875, datë 14.2.2008, "Për Metrologjinë" i ndryshuar, dhe VKM nr.1352 datë 03.10.2008 "Për aprovimin e rregullit mbi parapaketimin"



## SEKTORI I PRODUKTEVE ELEKTRIKE

Sektori i produkteve elektrike ka filluar inspektimet në muajin maj pas përfundimit të procesit të rekrutimit të 4 (katër) inspektorëve nga 6 në total që ka struktura e miratuar.

### 7. Inspektime për produktet elektrike

Gjatë vitit 2018, ky sektor ka kryer 123 inspektime<sup>10</sup>. Numri i produkteve të kontrolluara është 7475 nga të cilat 291 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur 34 masa administrative nga të cilat 7 janë gjoba, 22 paralajmërime dhe 5 masa urgjente. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat e për këto lloj inspektimesh.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		150
	Inspektime te kryera	numër		123
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		6
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		128
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër		34
	<i>Gjoba</i>	<i>numër</i>		7
	<i>Paralajmërime</i>	<i>numër</i>		22
	<i>Masa urgjente</i>	<i>numër</i>		5
	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me korrigjime	numër		0
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		
IND8	Ulja e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore në treg	%		3.9
	<i>Numër produktesh të kontrolluara</i>	<i>numër</i>		7475
	<i>Numër produktesh jo në konformitet</i>	<i>numër</i>		291

<sup>10</sup> Në zbatim të Ligjit nr. Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011“Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, Ligjit nr.68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, VKM Nr. 1061, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” si dhe rregullave teknike të miratuar për disa grup produktesh (kondicionerët e ajrit, makinat larëse, pajisje frigoriferike për përdorim shtëpiak, tharëse për përdorim shtëpiak, furra shtëpiake dhe aspiratorët thithës)

## SEKTORI I PRODUKTEVE MEKANIKE

Në lidhje me këtë sektor rekrutimi i inspektorëve përfundoi në nëntor 2018. Edhe pse ky sektor ka qenë në pjesën më të madhe të vitit pa staf, është punuar për ngritjen e bazës të të dhënave mbi ashensorët që disponojnë institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, institucionet dhe subjektet private duke përfshirë: hotele, qendra biznesi, spitale privatë, institucione arsimore private, etj. Është realizuar vetëm një inspektim i ashensorëve mbi bazën e një ankese, dhe është marrë masa e bllokimit pas analizës së dokumentacionit dhe elementëve të sigurisë.

Shkalla e informacionit të komunitetit, bizneseve dhe përdoruesve të tjerë të ashensorëve në lidhje me sigurinë e ashensorëve është shumë e ulët dhe në informimin e tyre në lidhje me detyrimet që i ngarkon legjislacioni në fuqi janë organizuar takime, trajnime, etj. si dhe janë shpërndarë materiale informuese.

### 2.1.2 NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE TË DMP -SË

Inspektorët e kësaj drejtorie kanë marrë pjesë në disa trajnime duke iu referuar fushave specifike, pjesa më e madhe e të cilave janë mbështetur nga projektet GIZ dhe Quality Infrastructure in the Western Balkans duke përmendur në mënyrë të veçantë:

Në kuadrin e projektit të GIZ “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik e tregtar me Acquis-në e BE-së” janë realizuar trajnime dhe workshope mbi inspektimin e produkteve specifike dhe zbatimin e një qasjeje të re për inspektimet e fushë-veprimtarisë konkretisht: Njohja me principet bazë dhe praktikën më të mira për rritjen e efikasitetit gjatë kontrollit për zbatimin e legjislacionit në fuqi lidhur me produktet: Instrumentet matës ligjërish të kontrolluar, peshoret jo-automatike (NAVI, MIDI), produktet elektrike, detergjente, këpucë e tekstile.

Me mbështetjen e GIZ, është mundësuar trajnimi i inspektorëve të sektorit të produkteve elektrike mbi ashensorët.



Në kuadrin e Projektit “Quality Infrastructure in The Eastern Balkans” janë realizuar trajnime mbi sistemet e shpejta të shkëmbimit të informacionit për raportimin e produkteve jo-ushqimore të rrezikshme RAPEX/ICSMS të Komisionit Evropian, zbatimin e NAWI për instrumentet e kontrollit jo-automatik, Inspektimi i instrumenteve matës ligjërish të kontrolluara, mbledhja e të dhënave dhe zhvillimi i inteligjencës në mbikëqyrjen e tregut që çon në vendosjen efektive të

burimeve të ISHMT-së duke përfshirë këtu edhe autoritetet doganore, Modeli për bashkëpunim dhe kontrollet për mallrat që mund të kryhen në Kufi, etj.

Në këto trajnime kanë marrë pjesë të gjithë inspektorët e DMP. 6 inspektorë nga 23 në total që ka aktualisht DMP kanë marrë pjesë në më shumë se 2 trajnime.

### 2.1.3 AKTIVITETE SENSIBILIZUESE

#### Aktivite për sigurinë e lodrave

Me rastin e festës së Fëmijëve në 1 Qershor 2018, ISHMT në bashkëpunim me MFE , mbështetur nga projekti GIZ “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik e tregtar me Acquis-në e BE-së” u organizua një fushatë ndërgjegjësimi “Siguria e lodrave” . Fushata konsistonte në shpërndarjen e fletëpalosjeve me një informacion të hollësishëm dhe të vlefshëm për prindërit lidhur me elementët kryesorë, që një produkt lodër duhet të përmbajë në mënyrë që të konsiderohet i sigurt, të bluzave dhe çantave ku janë stampuar mesazhe informuese dhe sensibilizuese, në dy Info-pointet e ngritur pranë Parkut Rinia dhe digës së liqenit artificial.



Gjithashtu u organizua edhe një workshop me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të grupeve të interesit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve e Bashkisë Tiranë, Qendra “Konsumatori Shqiptar”, Shoqata e Konsumatorit Shqiptar, institucioneve publike duke konsistuar në njohjen nga ana e operatorëve ekonomikë që

importojnë/prodhojnë lodra, të detyrimeve që duhet të plotësojnë në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Fletëpalosje për sigurinë e produkteve Janë printuar fletëpalosje për sigurinë e ashensorëve, sigurinë e lodrave, sigurinë e detergjentëve, siguria e pajisjeve elektrike të tensionit të ulët, përputhueshmëria elektromagnetike e pajisjeve, të cilat janë shpërndarë dhe janë pasqyruar edhe në websit-in e ISHMT-së.

Takime sensibilizuese Janë organizuar disa takime me përfaqësues të Bashkisë së Tiranës në lidhje me njohjen e administratorëve të banesave në lidhje me përgjegjësitë që kanë për sigurinë e ashensorëve në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe dy takime me përfaqësues /administratorë/instalues të spitaleve private, qendrave të biznesit, hoteleve për njohjen e tyre me detyrimet që i ngarkon Ligji<sup>11</sup>.

## 2.2. DREJTORIA E PRONËSISË INDUSTRIALE DHE INTELEKTUALE (DPII)

### Përshkrim i shkurtër

Drejtoria e Pronësisë Industriale dhe Intelektuale përbëhet nga një staf prej 16 inspektorësh të ndarë në dy sektorë:

- a) Sektori i së Drejtës së Autorit (1 Përgjegjës Sektori , 7 inspektorë)
- b) Sektori i Pronësisë Industriale (1 Përgjegjës Sektori, 7 inspektorë)

Fusha e veprimtarisë së kësaj drejtorie është:

- ✓ Inspektimi i Pronësisë Industriale
- ✓ Inspektimi të Drejtës së Autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me to

### 2.2.1. INSPEKTIVE TË KRYERA

Për vitin 2018 DPII ka pasur si prioritete:

- ✓ Inspektimet për respektimin e të drejtave të autorit për:
  - përdoruesit e programeve kompjuterike
  - Fotokopje & shtypshkronja
  - radio, kabllor
  - hotele, bar-kafe, restorant
  - pirateri online
- ✓ Inspektime mbi cënimin e titujve të pronësisë industriale.

DPII gjatë vitit 2018 ka kryer **737 inspektive** nga të cilat 108 kanë qenë mbi bazë ankese. Janë informuar mbi 1551 subjekte dhe janë vendosur 179 masa administrative nga të cilat 103 gjoba dhe 76 paralajmërime.

<sup>11</sup> Ligji Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, VKM Nr. 192, datë 04.04.2018, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.

## 1. Inspektime për respektimin e të drejtave të autorit

Gjatë vitit 2018, janë kryer **401 inspektime**, nga të cilat 96 kanë qënë të nxitur nga ankesa<sup>12</sup>. Janë informuar rreth 1218 subjekte. Janë vendosur 105 masa administrative nga të cilat 98 gjoba dhe 7 paralajmërim.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		563
	Inspektime te kryera	numër		401
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		96
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		1218
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër		105
	<i>Gjoba</i>	<i>numër</i>		98
	<i>Paralajmërim</i>	<i>numër</i>		7
	<i>Masa urgjente</i>	<i>numër</i>		0
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		296

## 2. Inspektime mbi pronësinë industriale

Sektori i pronësisë industriale ka realizuar 336 inspektime nga të cilat 11 janë kryer mbi bazë ankese<sup>13</sup>. Janë informuar 333 subjekte dhe janë vendosur 74 masa administrative nga të cilat 69 paralajmërim dhe 5 gjoba.

IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		318
	Inspektime te kryera	numër		336

<sup>12</sup> Në zbatim të Ligjit Nr. 35/2016 datë 31.03.2016 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të lidhura me to” për subjektet /përdorues të programeve kompjuterike

<sup>13</sup> Në zbatim të Ligjit organik Nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar i cili parashikon: Rregullimin e sistemit të dhënies dhe të Mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale. Objekt i mbrojtjes së pronësisë Industriale 1. Patentat dhe modelet e përdorimit 2. Dizenjo Industriale 3. Marka tregtare dhe të shërbimit 4. Treguesit Gjeografikë

IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		12
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		333
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër		75
	<i>Gjoba</i>	<i>numër</i>		5
	<i>Paralajmërimi</i>	<i>numër</i>		69
	<i>Masa urgjente</i>	<i>numër</i>		0
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		262

## 2.2.2 NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE TË DPII

Inspektorët e të dy sektorëve të DPII kanë marrë pjesë në trajnime, seminare, workshope të organizuar nga aktorë të ndryshëm duke përmendur:

- ✓ Webinar me temë “Guida e Pronësisë Intelektuale” organizuar nga Zyra për Pronësinë Intelektuale të UK (Shkurt 2018).
- ✓ Webinar nga Akademia EËIPO mbi çështje të ndryshme mbi rregullimin e pronësisë industriale.
- ✓ Konferenca Kombëtare “Pronësia Industriale – Forca e ndryshimit: Gratë në Inovacion dhe Krijimtari”, organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (Maj 2018).
- ✓ Aktiviteti "Tryezë ndër - rajonale për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me të: Traktati i Marrakesh dhe Traktati i Pekinit” , organizuar nga Ministria e Kulturës (Mars 2018).
- ✓ Seminari mbi falsifikimin e mallrave, organizuar nga organizata REACT (Janar 2018).
- ✓ Trajnimin “Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis të BE-së” organizuar nga GIZ, (Tetor 2018).
- ✓ Trajnimin ”Industrial Property from the perspective of Enforcement for Inspectors of State Inspectorate of Market Surveillance” (pronësia Industriale në këndvështrimin e forcimit të rolit të inspektorëve e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, organizuar nga GIZ (Tetor 2018).

- ✓ Trajnimin “Intellectual Property Enforcement Models” (Modelet e zbatimit (përforcimit) të Pronësisë Intelektuale), organizuar nga GIZ (Tetor 2018).



### 2.2.3. AKTIVITETE SENSIBILIZUESE

Spektori i të drejtës së autorit, në përmbushje të detyrave të veta funksionale, ka ndërmarre një fushatë informuese dhe ndërgjegjësuere në lidhje me përdoruesit e veprave letrare specifikisht fotokopje dhe shtypshkronja si dhe përdoruesit e programeve kompjuterike. Së pari nga ky sektor u bë identifikimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si fotokopje dhe shtypshkronja për zonën e Tiranës dhe Durrësit, duke hedhur bazat për krijimin e një baze të dhënash. Më pas këto subjekte u informuan në lidhje me detyrimet që i ngarkon ligji<sup>14</sup> dhe mbi masat administrative në rastet e mosrespektimit të kërkesave ligjore të shprehura në këtë ligj. U informuan rreth 96 subjekte.

## 2.3 DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE NË TURIZËM (DMST)

### Përshkrim i shkurtër

Drejtorja e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm ishte pjesë e strukturës së ISHMT-së deri në fund të muajit qershor 2018 sepse me VKM nr. Nr. 383, datë 27.6.2018 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë në Njësitë e Qeverisjes Qendrore për vitin 2018”, kjo drejtori kaloi si pjesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

Kjo drejtori kishte një staf prej 21 punonjësish e organizuar në 2 sektorë:

- 1) Sektori i Strukturave Akomoduese
- 2) Sektori i Agjencive të Udhëtimit dhe Udhërrëfyesve Turistikë.

<sup>14</sup> Ligji 35/2016 dt. 31/03/2016 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të lidhura me to”

Fusha e veprimtarisë së kësaj drejtorie ishte:

- ✓ Inspektimi i Strukturave akomoduese
- ✓ Inspektimi i Agjencive të udhëtimit & Udhërrëfyesve Turistikë

### 2.3.1. INSPEKTIME TË KRYERA

Për vitin 2018 DMST ka pasur si prioritete:

- ✓ Inspektimi i Agjencive të Udhëtimit
- ✓ Inspektimi i Operatorëve Turistikë

Janë kryer gjithsej **258 inspektime**, nga të cilat 225 inspektime të planifikuara dhe 17 inspektime të paplanifikuara dhe janë vendosur 12 masa administrative, të gjitha gjoba.

#### 1. Inspektimi i Agjencive të Udhëtimit & Operatorët Turistikë (AU & OT)


IND.	PËRSHKRIMI	Matja	2017	2018
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	numër		339
	Inspektime të kryera	numër		258
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	numër		17
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	numër		n/a
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	numër		258
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	numër		12
	<i>Gjoba</i>	<i>numër</i>		<i>12</i>
	<i>Paralajmërime</i>	<i>numër</i>		<i>0</i>
	<i>Masa urgjente</i>	<i>numër</i>		<i>0</i>
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	numër		
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	numër		246

Nga inspektimi i kryer në 258 subjekte AU & OT, pas verifikimit të dokumentacionit rezultuan 97 subjekte (37,6%) që operonin në përputhje me kërkesat ligjore. Të gjitha subjektet që nuk plotësonin kërkesat ligjore konform legjislacionit në fuqi në bazë të Ligjit nr.10443 “Për



inspektimin në RSH” ju la afat për plotësimin e tyre, nga të cilat vetëm **149 subjekte korrigjuan shkeljet**. Për shkak të konstatimit pa licencë dhe mospërmbushjes së detyrave të lënë afat, ndaj 12 subjekteve u ndërmorrën masa administrative gjombë sipas Nenit 71/ pika c te Ligjit 93/2015 “Për Turizmin”.

Si rezultat i inspektimit nga 147 subjekte që plotësuan kriteret ligjore pas afateve të lëna nga inspektorët 31.5 % e tyre u pajisën me licencë, 25.5% e tyre regjistruan punonjësin e dytë<sup>15</sup>, 20.8% e tyre plotësuan kontratën me klientin<sup>16</sup>, 10.7% kontratën e bashkëpunimit me operatorë të tjerë, 4.7% e tyre plotësuan kontratën e sigurimit<sup>17</sup>. Një rezultat tjetër nga procesi i inspektimeve ishte dhe ndryshimi i përshkrimit të ekstraktit të QKB-së nga 15.4% e subjekteve, ku pas verifikimit të dokumentacionit dhe ambjentit të ushtrimit të veprimtarisë nga inspektorët, u evidentua mos ushtrimi i veprimtarisë si AU apo OT.



## 2.4 DREJTORIA TEKNIKE (DT)

### Përshkrim i shkurtër

Drejtorja Teknike ka në strukturën e saj 5 personel nga të cilët vetëm 2 janë rekrutuar nga DAP, si rrjedhim, Drejtorja Teknike është në kushtet e mungesës së stafit.

Fusha e veprimtarisë së kësaj drejtorie është:

<sup>15</sup> Neni 2/pika 2 e VKM nr. 709, datë 12.10.2016 “Për miratimin e kërkesave dhe kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit”

<sup>16</sup> Neni 2/pika 9 e VKM nr. 709, datë 12.10.2016 “Për miratimin e kërkesave dhe kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit”

<sup>17</sup> Neni 2/pika 7, VKM Nr. 710, datë 12.10.2016 “Për miratimin e kërkesave dhe kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik”

- ✓ Koordinimi i mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të informacioneve mbledhur nga dy drejtoritë e tjera;
- ✓ Analiza e raporteve periodike të dorëzuar nga çdo sektor në lidhje me punën e kryer në terren (inspektime), problematikën e hasur dhe sugjerimet për përmirësimin në vazhdimësi;
- ✓ Përpunimi i statistikave të mbledhura mbi inspektimet e kryera gjatë kësaj periudhe kalendarike në raport me Indikatorët e Performancës;
- ✓ Analiza e Feedback-ut nga aktorë të ndryshëm (publikë, privatë, ndërkombëtarë) me përvojë dhe eksperiencë në fushat që janë në fokusin e punës së ISHMT-së;
- ✓ Analiza e procedurave të inspektimeve, të performancës, proceseve gjyqësore, trajtimit të ankesave etj.;
- ✓ Raportimi i brendshëm e i jashtëm i ISHMT-së.

#### **2.4.1 Raporte të hartuara**

Kjo drejtori ka gjeneruar raporte periodike të brendshme dhe për institucione e organizma të tjera sipas kërkesave të vazhdueshme drejtuar ISHMT-së. Raportet e hartuara nga kjo drejtori janë:

- ✓ Raportimet periodike të ISHMT-së (6-mujore dhe vjetore);
- ✓ Raportimet për Planin Kombëtar Për Integrimin Evropian (PKIE) 2017 – 2020 (kapitullin 1, kapitullin 7 dhe kapitulli 28 );
- ✓ Raportimet për Strategjinë Ndër-sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2020;
- ✓ Raportimet për Kontratën e Performancës me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë;
- ✓ Raportin për Inspektoratin Qendror (IQ) mbi inspektimet e realizuara në bazë të një liste indikatorësh të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm.

#### **2.4.2 Mbështetje në zbatimin dhe hartimin e metodologjive të lidhura me procesin e inspektimit**

DT ka mbështetur DMP në përpilimin e listë-verifikimeve për inspektimin e produkteve elektrike, produkteve mekanike, produkteve tekstile, kimikateve, etj.

Ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me IQ në lidhje me zbatimin e sistemit të inspektimit on-line, E-inspection, mbi problematikat e ndeshura, eliminimin e tyre, etj.

DT ka mbledhur të dhëna statistikore nga çdo sektor/drejtori në lidhje me inspektimet të cilat hidhen rregullisht në një database, përpunohen dhe prezantohen në raporte të ndryshme si dhe shërbejnë si bazë për monitorimin e punës së ISHMT-së duke evidentuar problematikat dhe përcaktuar mënyrat për minimizimin/ose eliminimin e tyre.

## 2.5 SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Sektori i Financës dhe Shërbimeve mbështetëse ka në strukturë 8 punonjës nga të cilët janë emëruar vetëm 6 punonjës Përgjegjës Sektori, Specialisti i financës, Jurist (2), Magazinier dhe Specialist protokolli.

### 2.5.1 Ndjekja e ankimeve administrative të gjobave të vendosura nga strukturat e ISHMT

Gjatë vitit 2018 janë trajtuar 115 Ankime Administrative nga të cilat:

53 Ankime Administrative gjobë janë lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimit.

62 Ankime Administrative gjobë janë shfuqizuar nga Komisioni i Ankimit.

### 2.5.2 Përfaqësimi i ISHMT-së në procese gjyqësore

Një pjesë e gjobave të ankimuara në rrugë administrative janë ankimuar edhe gjyqësisht dhe kontestojnë në themel vlefshmërinë e gjobës.

Në total ISHMT ka qenë në proces gjyqësor në cilësinë e Palës së Paditur në **29 çështje gjyqësore**. Për 11 çështje, Gjykata Administrative ka dalë me vendim përfundimtar në favor të ISHMT-së dhe për 6 të tjerat janë pranuar kërkesëpaditë në favor të palëve paditëse. Pjesa tjetër e çështjeve gjyqësore është ende në proces.

Në tabelat e mëposhtme jepen të dhëna statistikore lidhur me gjobat në total, ankimet administrative, gjyqësore dhe gjobat e paekzekutueshme.

#### Gjobat në total, 2018

Gjoba total	Ankime administrative (numër)	Ankimeve gjyqësore	Gjoba të rrëzuara nga	Gjoba të lëna në fuqi	Nr.Gjoba në proces gjyqësor	Nr.Gjobave të paekzekutu
183	115	29	6	11	12	0

#### Gjobat e ekzekutuara, 2018

Nr.Kërkesave për lëshim U.E	Nr.i U.E të lëshuara dhe drejtuar Përmbarimit	Gjoba të arkëtuara <sup>2</sup>	Masa disiplinore inspektorëve
84	58	19	0

Gjatë vitit 2018 numri i gjobave të paekzekutueshme është 0.

### 2.5.3 Buxheti & Financa

Për ISHMT-në në fillim të vitit 2018 janë çelur fondet buxhetore sipas llogarive si më poshtë:

LLOGARIA	EMERTIMI	SHUMA (LEKË)
<b>FONDET E CELURA</b>		
600	Paga	90.000.000
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	13.000.000
602	Shpenzime korente	13.000.000
231	Investime	16.000.000
<b>TOTALI</b>		<b>132,000,000</b>
<b>FONDET E SHPENZUARA</b>		
600	Paga	49.139.599
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	8.141.194
602	Shpenzime korente	9.724.459
231	Investime	5.755.529
<b>TOTALI</b>		<b>72.760.781</b>

Për pagat e punonjësve të ISHMT janë paguar 49.139.599 lekë ose 54.6% e totalit të pagave të çelur në fillim të vitit buxhetor 2018 në shumën 90.000.000 lekë.

Po kështu për Sigurimet Shoqërore Shëndetësore dhe Tatimet për pagat e marra nga punonjësit e ISHMT janë paguar 8.141.194 lekë ose 62.63 % e totalit të vitit buxhetor 2018 në shumën 13.000.000 lekë të sigurimeve të çelur në fillim të vitit 2018 .

Për zërin e Investimeve janë përdorur 5.755.529 lekë ose 36 % e totalit të vitit buxhetor 2018 në shumën 16.000.000 lekë të çelur në fillim të vitit 2018 .

Nga planifikimi i zërit të investimeve për vitin 2018 nuk janë realizuar investimet e mëposhtme:

- Rikonstruksioni i ambjenteve të ISHMT në vlerën 2 000 000 lekë me tvsh.
- Blerje Pajisje Zyre në vlerën 2,000,000 lekë me tvsh pasi ISHMT nuk disponon ambiente për të kryer veprimtarinë e saj.
- Blerje Pajisje Laboratorike në vlerën 5,442,000 lekë me tvsh për shkak të anulimit dy herë të procedurave të prokurimit publik zhvilluar nga ana e Agjensisë së Blerjeve të Përqëndruara.
- Blerje Pajisje Kompjuterike (Printera) në vlerën 617,271 lekë me tvsh për shkak të mosfinalizimit të procedurës së prokurimit publik nga AKSHI si rezultat i ankimimeve.

Për vitin 2018 është janë arkëtuar nga gjobat 4,420,633 lekë.

Mos përdorimi i të gjithë fondit 600 dhe 601 të planifikuar për vitin 2018 është për arsye të mos plotësismit të strukturës së miratuar të ISHMT-së ku aktualisht janë emëruar 51 punonjës nga 69 që është struktura e re e miratuar me Urdhrin nr. 107 datë 31.07.2018.

### III. ISHMT – SFIDA / KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

#### 3.1. Sfidat Gjatë Vitit 2018

Viti 2018 është viti i dytë i punës së ISHMT dhe si një institucion i ri, ndeshet me një numër të konsiderueshëm vështirësish dhe sfidash të listuara më poshtë:

Mungesa totale e ambienteve të përshtatshme për punë dhe e logjistikës së nevojshme për mbarëvajtjen e punës. ISHMT vazhdon të disponojë ambiente të kufizuara pune në ambientet e MFE-së, kur aktualisht numri i stafit është 45 persona.

Mungesa e automjeteve për inspektim të cilat sjellin vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve, duke pasur në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale (i gjithë territori i vendit) të ushtrimit të funksionit të ISHMT-së.

Mungesa e auto laboratorëve/pajisjeve/instrumenteve të nevojshme për të realizuar të gjitha proceset e inspektimit që janë në fokusin e këtij institucioni. Edhe pse nga ana e ISHMT-së është kërkuar tenderimi i disa instrumenteve/pajisje brenda vlerave që lejon buxheti i miratuar për ISHMT-në (zëri 231 – Investime), procedura e prokurimit nuk është finalizuar nga ana e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara.

Mungesë eksperience e stafit në fushën e inspektimit dhe në fushat specifike që janë në fokusin e ISHMT-së. Shumë prej fushave si siguria e produkteve elektrike, mekanike, qelq/këpuca/detergjentet, pronësia industriale, veprimtaritë turistike janë fusha që për herë të parë përfshihen në procese inspektimi.

Buxhet që nuk i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të institucionit duke pasur parasysh gamën e gjerë të fushë veprimtarisë dhe mbulimin e gjerë territorial të ISHMT-së, e cila është e organizuar si Drejtori Qendrorë (pa degë rajonale).

Shkalla e ulët e informimit të subjekteve, në lidhje me kuadrin ligjor dhe detyrimet që rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore të miratuar sipas fushave specifike, inspektimi i të cilave është në fokusin e ISHMT-së, është një nga problemet që vështirësojnë së tepërmi punën e ISHMT.

Numër i kufizuar kapacitetesh njerëzore për shkak të procesit të zgjatur të rekrutimit. Për një kohë të gjatë ka pasur sektorë me mungesë totale të stafit si sektori i produkteve mekanike (u finalizua në nëntor 2018), sektori i produkteve elektrike (u finalizua në maj 2018). Kjo lidhet me procedurën e rekrutimit nga DAP që kërkon kohën e saj si dhe në jo pak raste të dështimit të këtij procesi për shkak të mos arritjes së pikëve të duhura për kualifikim të kandidatëve. Edhe sektorët e tjerë kanë patur mungesa në staf.

Bashkëpunim për t'u përmirësuar ndërinstitucional duke përmendur në radhë të parë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganës, Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, AKEP, AMA, etj.

Mangësi dhe boshllëqe në kuadrin ligjor ekzistues për disa grup-produkte ose për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, të cilat sjellin pengesa në zbatimin e procedurave, ose që nuk janë në përputhje me direktivat e BE që janë transpozuar tashmë në legjislacionin shqiptar.

**Në lidhje me procesin e inspektimit** gjatë vitit 2018 Inspektorët e ISHMT-së janë ndeshur me disa probleme:

- ✓ Mos gjetja e operatorëve ekonomikë në adresat që kanë deklaruar në QKB si dhe të mos deklarimit të ndryshimit të veprimtarisë së tyre pranë këtij organi. Gjatë vitit 2018 janë rreth **210 inspektime të planifikuara por që nuk janë realizuar** për shkak të mosgjetjes së operatorit ekonomik në adresën që ka deklaruar në QKB ose të ndryshimit të objektit të veprimtarisë së tij. Edhe pse e kemi ngritur disa herë këtë shqetësim edhe në komunikimin zyrtar me QKB nuk kemi marrë akoma nje zgjidhje.
- ✓ Vonesa ose pengesa nga Posta Shqiptare në lidhje me dërgimin e njoftimeve të inspektimit ose të Vendimeve Përfundimtare të Inspektimit pranë operatorëve ekonomikë. Me këtë institucion kemi komunikuar në vazhdimësi sepse është i lartë numri i zarfave të kthyer nga punonjësit e këtij institucioni me shënimet që *nuk gjendet adresa, adresë e panjohur*, por vazhdon të mbetet si problem shqetësues.

### 3.2.Rekomandime

Rekomandimet janë ngushtësisht të lidhura me sfidat e ndeshura gjatë vitit 2018. Ndaj si rekomandime kryesore mund të përmendim:

- ✓ Pajisja e ISHMT-së me ambiente zyre dhe logjistikën përkatëse.
- ✓ Vijimi i procedurave rekrutuese të stafit të miratuar në organikën e ISHMT-së dhe rishikimi i strukturës së saj sipas gjetjeve dhe nevojave të identifikuara në procesin e ngritjes, monitorimit dhe raportimit të aktivitetit të saj.
- ✓ Pajisja me autolaboratorë/pajisje/instrumente të nevojshme për të realizuar të gjitha proceset e inspektimit që janë në fokusin e këtij institucioni. Lidhja e marrëveshjeve dhe gjetja e rrugëve institucionale për testimin e mostrave në laboratorë të akredituar jashtë vendit, në kushtet kur ka një mungesë thuajse të plotë të laboratorëve të akredituar për produktet joushqimore në vend.
- ✓ Pajisja me mjete transporti për të lehtësuar procesin e inspektimit duke mbuluar të gjithë territorin e vendit.

- ✓ Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional që do ti shërbejë punës dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe aksioneve në mbrojtjen e konsumatorit dhe në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të sigurta dhe cilësore.
- ✓ Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të ISHMT-së nëpërmjet trajnimeve, seminareve, workshopeve, vizitave studimore duke synuar rritjen e shkallës së profesionalizmit dhe implementimin e metodave bashkëkohore në fushën e inspektimit veçanërisht për sigurinë e produkteve joushqimore.
- ✓ Rritja e aksesit të subjekteve ndaj informacionit për detyrimet që duhet të plotësojnë në zbatim të legjislacionit ekzistues sipas fushave specifike që janë në fokusin e ISHMT-së.
- ✓ Rritja e aksesit të konsumatorit ndaj informacionit mbi sigurinë e produkteve joushqimore duke e bërë pjesëmarrës në rritjen e cilësisë së shërbimeve.
- ✓ Përmirësime në legjislacionin ekzistues që mbulojnë disa grup-produkte ose që kanë lidhje me respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale duke përmendur:
  - Ndryshime të disa dispozitave të **Ligjit Nr. 10216/2010 “ Për Detergjentët”** përsa i përket “rrezikshmërisë”, vlerësimin e rrezikut, të dhënat e sigurisë dhe mbi etiketimin/paketimin /klasifikimin të cilat duhet të jenë në përputhje me Ligjin Nr.27/2016 dhe akteve në zbatim.
  - **Miratimi i procedurës së shkatërrimit të produkteve** që është draftuar dhe zbatimi i saj për bërjen jo funksional të produkteve që janë aktualisht nën masën e bllokimit në mungesë të kërkesave thelbësore të sigurisë.
  - **Përmirësime në Ligjin nr.9947, datë 0707.2008 “Për pronësinë industriale”** sepse në ligjin ekzistues nuk përcaktohet qartë: procedura e veprimtarisë së inspektorëve; instrumentat ligjorë që përdorin inspektorët; komunikimi ndër institucional, ku më të rëndësishme janë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe mbartin mangësi thelbësore ligjore të inspektimit.

#### IV. PRIORITETET PËR VITIN 2019

Veprimtaria e ISHMT-së për vitin 2019 do të mbështetet përsëri në 3 shtylla:

- I. Veprimtari mbikëqyrëse për rreptimin e kritereve ligjore nga operatorët ekonomikë për produktet joushqimore dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.
- II. Aktivitete sensibilizuese
- III. Ngritje kapacitetesh

Në lidhje me **shtyllën e I-rë** prioritet e ISHMT-së për vitin 2019 do të jenë si më poshtë:

##### **Për Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Produkteve**

Inspektimet për sigurinë e produkteve do të përfshijnë inspektime të planifikuara (sipas Programit të inspektimeve të miratuar) dhe inspektime të pa planifikuara mbi bazën e ankesave të ardhura pranë ISHMT-së nga konsumatorët, operatorët ekonomikë, të njoftimeve nga Dogana apo institucione të tjera publike me të cilat bashkëpunon ky institucion .

Për Sektorin e Metrologjisë në zbatim të Ligjit Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, Ligjit Nr.9875, datë 14.2.2008 “Për Metrologjinë” i ndryshuar, prioritet do të jenë:

1. Inspektimi i instrumentave ligjërish të kontrollueshme;
2. Inspektimi i parapaketimeve;
3. Inspektimi i matësve të ujit.

Për Sektorin e Qelqit, Këpucëve, Detergjentëve/Sigurisë së Produkteve në zbatim të legjisllacionit në fuqi<sup>18</sup>, prioritet do të jenë:

1. Inspektimi i lodrave;
2. Inspektimi i detergjentëve;
3. Inspektimi i tekstileve;
4. Inspektimi i veshjeve të këmbës;
5. Inspektimi i produkteve që nuk mbulohen nga një rregull teknik (artikujt e kujdesit ndaj fëmijëve, bizhuteritë, etj)

Për Sektorin e Produkteve Elektrike në zbatim të legjisllacionit në fuqi<sup>19</sup>, prioritet do të jenë:

1. Inspektimi i pajisjeve elektrike që mbulohen nga një rregull teknik (makinat larëse, pajisjet ftohëse, tharëset për përdorim shtëpiak, kondicionerët, etj.)
2. Inspektimi i produkteve elektrike që nuk mbulohen nga një rregull teknik (karikuesit, zgjatuesit, adaptorët, ushqyesit, etj.)

Për Sektorin e Produkteve Mekanike në zbatim të Ligjit Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, VKM Nr. 1060, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për makineritë” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, VKM Nr. 192, datë 04.04.2018, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, prioritet do të jenë:

<sup>18</sup> Ligji Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, Ligji nr.27, datë 17.03.2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, Ligji nr. 10 216, datë 21.1.2010 “Për detergjentët”, VKM nr.222, datë 28.03.2012 “Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”, VKM nr.1058, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile”, VKM nr.669 , datë 28.09.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët”, VKM Nr. 262, datë 03.04.2013, “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”

<sup>19</sup> Ligji Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, Ligji nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” , VKM Nr. 1061, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”



1. Inspektimi i ashensorëve
2. Inspektimi i makinerive/pajisjeve

### **Për Drejtorinë e Pronësisë Industriale dhe Intelektuale**

Inspektimet për respektimin e të drejtave të autorit dhe të pronësisë industriale do të përfshijnë inspektime të planifikuara dhe inspektime të pa planifikuara mbi bazën e ankesave nga konsumatorët, operatorët ekonomikë , të njoftimeve nga Dogana , SUADA, palë të treta, etj.

Për Sektorin e të Drejtave të Autorit në zbatim të Ligjit nr.35 datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, prioritetet do të jenë:

1. Inspektimi i librit (shtëpive botuese, shtypshkronjave, librarive)
2. Inspektimi i fotokopjeve
3. Inspektimi i programeve kompjuterike

Për Sektorin e Pronësisë Industriale në zbatim të Ligjit Ligji Nr. 9947, datë 07/07/2008, “Për pronësinë industriale” (i ndryshuar), prioritetet do të jenë:

1. Inspektimi i markave tregtare (veshje, këpucë, pajisje elektronike, detërgjente, etj)

Në lidhje me **shtyllën e II-të** prioritetet do të jenë:

- Organizim aktivitetesh sensibilizuese në bashkëpunim me institucine të tjera shetëtrore dhe private, Dhomat e Tregëtisë, OJF-të , etj, me fokus operatorët ekonomikë në lidhje me kriteret ligjore që duhet të zbatohen mbi produktet joushqimore.
- Fushata sensibilizuese me fokus konsumatorin.
- Botim dhe shpërndarje fletëpalosjesh/broshura informative mbi disa grup-produkte.
- Përditësimi i informacionit në web-site [www.ishmt.gov.al](http://www.ishmt.gov.al)

Në lidhje me **shtyllën e III-të** prioritetet do të jenë:

-Trajnime të stafit në lidhje me Legjislacionin e BE-së (direktivat e transpozuar ne legjislacionin shqiptar) për grupe produktesh: makineri, pajisje nën presion, instrumentat ligjërish të kontrollueshme, ashensorë,

- Trajnime të stafit në lidhje me përdorimin e pajisjeve/instrumentave të nevojshme për kryerjen e inspektimeve.

**Tabela1: Indikatorët e vlerësimit të punës së ISHMT-së për vitin 2018**

<b>Ind.</b>	<b>PËRSHKRIMI</b>		<b>Vlera e Arritur 2018</b>
IND1	Inspektime të programuara nga ISHMT	%	<b>63</b>
IND2	Inspektime të kryera nga ISHMT nxitur nga ankesa apo shqetësime të marra nga konsumatorë/operatorë ekonomikë/dogana/ të tjerë	%	<b>7.6</b>
IND3	Inspektime të kryera nga ISHMT, nxitur nga ngjarje, aksidente apo incidente të ndodhura apo të mundshme	%	<b>n/a</b>
IND4	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me informim/këshillim të operatorëve ekonomikë	%	<b>53.1</b>
IND5	Inspektime të ISHMT që rezultojnë me dënime administrative	%	<b>15</b>
IND6	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në nisje procedimesh ligjore	%	<b>1.3</b>
IND7	Inspektime të ISHMT që rezultojnë në pajtueshmëri me detyrimet ligjore për produktet jo-ushqimore dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	%	<b>75.6</b>
IND8	Ulja e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore në treg	%	<b>10.3</b>
IND9	Numri i Rregulloreve, Udhëzimeve dhe Propozimeve ligjore që synojnë përmirësimin e praktikave të ISHMT-së	numër	<b>2</b>
IND10	Numri i Inspektorëve të ISHMT të trajnuar	numër	<b>43</b>
IND11	Numri i aktiviteteve / trajnimeve të ofruara nga ISHMT për konsumatorët /operatorët ekonomikë	numër	<b>7</b>
IND12	Numri i botimeve, fletëpalosjeve, spoteve publicitare, posterave, materialeve sensibilizuese dhe informuese hartuar nga ISHMT për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë	numër	<b>8</b>
IND13	Numri i vizitorëve të faqes elektronike të ISHMT	numër	<b>250</b>

Tabela2: Inspektimet e kryera nga ISHMT për vitin 2018 sipas sektorëve

	Sektorët/Drejtoritë	Numër inspektimesh të planifikuar	Numër inspektimesh të kryera	Numër inspektimesh të paplanifikuar	Numër masash administrative	Numër gjobash	Numër masa urgjente	Numër produktesh të kontrolluara	Numër produktesh jo në konformitet	Numër subjektsh të informuara
<b>1</b>	<b>Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve</b>		<b>1019</b>	<b>17</b>	<b>141</b>	<b>52</b>	<b>26</b>	<b>12817</b>	<b>1183</b>	<b>355</b>
1.1	Spektori i Produkteve Mekanike	0	0	1	0	0	0	0	0	0
1.2	Spektori i Produkteve Elektrike		123	6	34	7	5	7475	291	128
1.3	Spektori i Inspektimit Metrologjik		663	0	20	16	4	3891	422	0
1.4	Spektori i qelqit, këpucëve, detergjenteve/sigurisë së produkteve		233	10	87	29	17	1451	470	227
<b>2</b>	<b>Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale</b>		<b>737</b>	<b>108</b>	<b>179</b>	<b>103</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1551</b>
2.1	Spektori i Pronësisë Industriale		336	12	74	5	0	0	0	333
2.2	Spektori i të Drejtës së Autorit		401	96	105	98	0	0	0	1218
<b>3</b>	<b>Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve për Turizmin</b>		<b>258</b>	<b>17</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>258</b>
	<b>TOTALI</b>		<b>2014</b>	<b>142</b>	<b>333</b>	<b>167</b>	<b>26</b>	<b>12817</b>	<b>1183</b>	<b>2164</b>